

Ndikimi Ekonomik i DokuFest 2015

Shkurt 2016

parashikimet për 2016-2018



1. Hyrje

DokuFest është një ndër festivalet më të suksesshëm dhe më të njohur në rajon dhe botë për filma dokumentar dhe atyre të metrazhit të shkurtër. Në këtë festival marrin pjesë artistë të shumtë nga vende të ndryshme të botës. Ndikimi i DokuFest-it në jetën kulturore të vendit është një aspekt i cili tashmë është vlerësuar lartë nga shumë njohës të kësaj fushe.

Përveç aspektit kulturor, DokuFest ka një ndikim të madh në ekonominë e Prizrenit në veçanti, por edhe në atë të Kosovës në përgjithësi. Ndikimi ekonomik u dëshmuar në vitin 2011 përmes një analize të bërë nga Instituti GAP në bashkëpunim me DokuFest, ku bazuar në prirjen për importim 20% dhe në numrin e vizitorëve u vlerësua se ndikimi i DokuFest 2011 në Bruto Produktin Vendor (GDP) kapte vlerën vjetore prej 3.1 milionë euro, kurse bashkë me shpenzimet për konsum, vlera arrinte në 3.8 milionë euro.

Përfituesit kryesor nga ky festival ishin bizneset lokale në qytetin e Prizrenit, si: hotelet, qiradhënësit, restorantet, kafe-baret, shitësit ambulant, por edhe bizneset në nivel kombëtar, si avio-kompanitë, bankat dhe kompanitë e telekomunikacionit. Ky festival po ashtu njihet për krijimin e mundësive për punësim, krijimin e investimeve të reja, ngritjen e të hyrave tatimore, dhe stimulimin e ekonomisë lokale përmes turizmit.

Në edicionin e 14-të të DokuFest-it, pra atë të vitit 2015, të pranishëm ishin më shumë se 15,000 pjesëmarrës. Nga ta, rreth 7,000 apo 48%, merrnin pjesë për herë të parë, ndërsa moshë mesatare e tyre ishte rreth 26 vjet. Që nga viti 2011 e deri më tash, numri i pjesëmarrësve është rritur për më shumë se 50% dhe bazuar në trendet paraprake, ky numër do të vazhdojë të rritet edhe më shumë në vitet e ardhshme. Si rezultat, ndikimi i DokuFest 2015 në Bruto Produktin Vendor, me prirje për importim prej 48%, kap vlerën vjetore prej 2.4 milionë euro. Nëse llogariten edhe shpenzimet për konsum, ndikimi vjetor vlerësohet të jetë mbi 4.7 milionë euro.

Ky është raporti i dytë me radhë i Institutit GAP, i cili vlerëson ndikimin ekonomik të DokuFest-it. Ky raport paraqet ndikimin direkt dhe indirekt të festivalit në Bruto Produktin Vendor si dhe parashikime makroekonomike për vitet 2016-2018.

2. Metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është matja e ndikimit ekonomik të festivalit nëntë ditorë në qytetin e Prizrenit. Për shkak të informalitetit të lartë i cili ekziston në Kosovë, matja e saktë e këtij ndikimi dhe qarkullimit të parasë është e vështirë. Për këtë arsye Instituti GAP në bashkëpunim me organizatorët e DokuFest, kanë përpiluar një pyetësor i cili është plotësuar nga 1,015 respondentë – pjesëmarrës në DokuFest. Numri i vizitorëve në DokuFest i cili u mbajt më 8-16 gusht 2015, bazuar në numrin e biletave të shitura për të parë filmat e shfaqur në tetë kinematë e qytetit dhe pjesëmarrës në aktivitete të tjera të organizuara nga DokuFest-i, ishte mbi 15,000.

Mostra e të anketuarve prej 1,015 sosh, paraqet 1/15 e vizitorëve total të DokuFest-it, ose çdo i katërti person që ka blerë diçka në dyqanet e DokuFest. Kjo mostër konsiderohet gjithëpërfshirëse dhe e pranuar. Hulumtimi është bërë me vizitorë rezident dhe jorezident të qytetit të Prizrenit. Hulumtimi ka zgjatur nëntë ditë.

Përveç anketave, GAP ka siguruar të dhëna edhe nga Administrata Tatimore e Kosovës për të hyrat nga qyteti i Prizrenit gjatë muajve të verës. Të dhënat e ATK dëshmojnë se ka të hya më të larta gjatë muajit kur mbahet festivali i DokuFest.

3. Shkurt për DokuFest

Festivali i filmit dokumentar dhe të shkurtër DokuFest është ngjarja filmike dhe kulturore më e madhe në Kosovë, e cila mbahet çdo vit në qytetin e Prizrenit. Gjatë festivalit ka aktivitete të ndryshme kulturore. Përveç filmave që shfaqen gjatë ditës dhe në mbrëmje, ka edhe një numër aktivitete të tjera, si punëtori, trajnime, debate, ekspozita DokuPhoto, festivali për fëmijë DokuKids, kampingu i festivalit, koncertet muzikore DokuNights, konferenca teknologjike DokuTech, dhe Kabaretin Kino Prizreni. Për organizimin e festivalit angazhohen rreth 150 vullnetarë.

Gjatë edicionit të vitit 2015 janë shfaqur 228 filma dhe dokumentarë të shkurtër në tetë kinematë e qytetit. Përveç vizitorëve nga e gjithë Kosova dhe rajoni, aty marrin pjesë edhe mbi 300 mysafirë ndërkombëtarë dhe personalitete të shquara nga vendi dhe bota.

4. Ndikimi Ekonomik i DokuFest-it

Organizimi i festivalit DokuFest ka ndikim direkt dhe indirekt në ekonominë e vendit. Ndikimi direkt vjen nga shpenzimet që janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me organizmin e ngjarjeve.

Ndërsa ndikimi indirekt përfshin personat apo ndërmarrjet që përfitojnë nga organizimi i kësaj ngjarjeje, që në rastin e DokuFest-it janë ndërmarrësit që ofrojnë shërbime për vizitorët në transport, ushqim, rekreacion, akomodim, punësim sezonal si pasojë e rritjes së aktivitetit ekonomik e të tjera.

4.1 Ndikimi direkt

Për organizmin e festivalit DokuFest janë shpenzuar gjithsej 315,430 euro të mbledhura nga donatorë të ndryshëm, sponsorë, të hyra vetanake dhe huazime. Nga kjo shumë, mbi 131,000 euro janë shpenzuar në burime njerëzore, akomodim dhe transport; 29,000 euro në marketing; 18,000 euro në pajisje, logjistikë, dhe mirëmbajtje; dhe 136,000 euro në ndarje të çmimeve për fitues, organizimet e DokuNights, DokuPhoto, DokuKids, panele, Master Klasa dhe Punëtori, e të tjera. Pra përfituesit direkt të festivalit janë personat apo ndërmarrjet të cilat janë të përfshirë drejtpërdrejt me organizimin e festivalit.

4.2 Ndikimi indirekt


Në anën tjetër, për shkak të rritjes së numrit të vizitorëve dhe rrjedhimisht konsumit, gjatë festivalit DokuFest kanë përfituar edhe shumë ndërmarrje afariste në Prizren të cilat kanë ofruar shërbime të akomodimit, ushqimit, transportit, rekreacionit, e të tjera. Po ashtu, në krahasim me muajin korrik të vitit 2015, gjatë muajit gusht kur është mbajtur DokuFest, të hyrat tatimore janë ngritur për 44%¹. Në vijim janë paraqitur disa nga përfitimet indirekte të cilat vijnë nga banorët e Prizrenit si dhe vizitorët tjerë nga Kosova dhe vendet tjera të botës. Ky ndikim është llogaritur nga shpenzimet mesatare të deklaruara nga vizitorët në anketë.

¹ Të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), sipas kërkesë së Institutit GAP, janar 2016.


Bazuar në të dhënat e mbledhura, qytetarët e Prizrenit shpenzojnë mesatarisht nëntë euro në ditë. Kjo shumë përfshin shpenzimet ditore për ushqim, transport, dhe rekreacion. Krahasuar me ditët e zakonshme, gjatë këtij festivali qytetarët e Prizrenit pothuajse dyfishojnë shpenzimet ditore, prej nëntë euro në 17 euro në ditë.

4.2.1

Shpenzimet ditore të banorëve të Prizrenit



4.2.2

Shpenzimet e vizitorëve tjerë
gjatë ditëve të DokuFest

5. Ndikimi makroekonomik

Supozimet e modelit makroekonomik të Instituti GAP për ndikimin ekonomik të DokuFest-it janë:

1. Numri i përgjithshëm i vizitorëve në DokuFest 2015 është rreth 15,000 persona. Nga ky numër, 25% e pjesëmarrësve ishin nga Prizreni; 38% jashtë Prizrenit por banorë të Kosovës, dhe 37% vizitorë ndërkombëtar.
2. Shuma e shpenzuar për vizitorë është marrë nga anketa dhe vlerësohet se pjesëmarrësit nga Prizreni shpenzojnë mesatarisht 102 euro gjatë gjithë festivalit, personat jashtë Prizrenit shpenzojnë mesatarisht 184 euro, ndërsa vizitorët nga jashtë Kosova shpenzojnë 221 euro.
3. Në këtë model janë paraqitur dy projeksione, tabela e parë përfshin ndikimin ekonomik dhe largon efektin e importit, ndërsa tabela e dytë paraqet të gjitha shpenzimet.
4. Të dhënat e shpenzimeve tregojnë se një numër i madh i konsumit është i koncentruar tek shërbimet, e të cilat janë kryesisht vendore. Mirëpo me qarkullimin e parasë, në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 48% e produkteve të konsumuara importohen, për dallim me analizën e ndikimit ekonomik të DokuFest 2011, kur prirja për importim ishte supozuar 20% e që ka ndikim më të vogël në uljen e GDP-se se vlera e vitit 2015 që është 48%.
5. Ngjashëm me raportin e parë, edhe këtë vit modeli parashikon ndikimin ekonomik dhe ndikimin në konsum për 4 vite, duke përfshirë edhe efektin e multiplikatorit apo qarkullimit të parasë pas shpenzimit fillestar. Këtë vit, qarkullimi i parasë vlerësohet të jetë 1.78², vlerë kjo që kalkulohet nga të dhënat e ASK-së për ndryshimin e GDP-së dhe konsumit familjarë.
6. Bazuar në trendet paraprake të rritjes së numrit të vizitorëve, ky model parashikon një rritje prej 10% për tre vitet e ardhshme. Ndërsa shpenzimet për person dhe proporcioni i pjesëmarrësve prizrenas, të jashtëm, dhe ndërkombëtar, mbesin të njëjta. Rritja e numrit të vizitorëve është më e ulët krahasuar me raportin e fundit të bërë në vitin 2011, ngase me kalimin e viteve, festivali i afrohet përmbushjes së kapacitetit mbajtës.

² Multiplikatori është kalkuluar nga të dhënat e ASK-së për Bruto Produktin Vendor (BPV)

Formula e multiplikatorit: $m = 1 / (1 - mpc * (1 - TVSh) * (1 - mpi))$ TVSh = 18%

Prirja për konsum: $Mpc = \text{konsumi } 2014 - \text{konsumi } 2013 / \text{GDP } 2014 - \text{GDP } 2013$

Prirja për import: $Mpi = \text{importi i mallrave dhe shërbimeve } 2014 / \text{konsumi final } 2014$

5.1 Ndikimi në bruto produktin vendor (GDP)

Tabela: 1: Ndikimi i DokuFest-it në bruto produktin vendor (GDP) për vitin 2015, dhe parashikimet për vitet 2016-2018

Viti			2015		2015		2016		2017		2018	Total 4 vite
Nr. i vizitor.			15,000		15,000		16,500		18,150		19,965	Ndikimi direkt
Vendbanimi i vizitor.	Proporcioni	Shpenzimet EUR	Shpenzimet total në DokuFest		EUR	Rritja	EUR	Rritja	EUR	Rritja	EUR	EUR
Prizren	25%	102	382,500		198,900	10%	218,790	10%	240,669	10%	264,736	923,095
Jashtë Prizrenit	38%	184	1,048,800		545,376	10%	599,914	10%	659,905	10%	725,895	2,531,090
Ndërkombët arë	37%	221	1,228,215		638,672	10%	702,539	10%	772,793	10%	850,072	2,964,076
Total Shpenzime në Prizren / Kosovë			2,659,515	Ndikimi direkt në Ekonomi (GDP) në afat të mesëm	1,382,948		1,521,243		1,673,367		1,840,704	6,418,261
Multiplikatori i parasë në qarkullim në afat të mesëm (3vite)												
				1.78	2,461,647		2,707,812		2,978,593		3,276,452	11,424,504

5.2 Ndikimi në shpenzime për konsum

Tabela: 2: Ndikimi në shpenzimet për konsum për vitin 2015, dhe parashikimet për vitet 2016-2018

Viti			2015		2015		2016		2017		2018	Total 4 vite
Nr. i vizitor.			15,000		15,000		16,500		18,150		19,965	Ndikimi direkt
Vendbanimi i vizitor.	Proporcioni	Shpenzimet EUR	Shpenzimet total në DokuFest		EUR	Rritja	EUR	Rritja	EUR	Rritja	EUR	EUR
Prizren	25%	102	382,500		382,500	10%	420,750	10%	462,825	10%	509,108	1,775,183
Jashtë Prizrenit	38%	184	1,048,800		1,048,800	10%	1,153,680	10%	1,269,048	10%	1,395,953	4,867,481
Ndërkombëtarë	37%	221	1,228,215		1,228,215	10%	1,351,037	10%	1,486,140	10%	1,634,754	5,700,146
Total Shpenzime në Prizren / Kosovë			2,659,515	Ndikimi direkt në Ekonomi (prodhim vendor) në afat të mesëm	2,659,515		2,925,467		3,218,013		3,539,814	12,342,809
Multiplikatori i parasë në qarkullim në afat të mesëm (3vite)												
				1.78	4,733,937		5,207,330		5,728,063		6,300,870	21,970,200

6. Përfundimi

Në këtë raport është vlerësuar ndikimi ekonomik i festivalit DokuFest. Si përfundim del se ky festival ka rritur aktivitetin ekonomik (GDP) për mbi 2.4 milionë euro. Nëse llogariten edhe shpenzimet për konsum, ndikimi vjetor vlerësohet të jetë mbi 4.7 milionë euro. Në krahasim me analizën paraprake, atë për ndikimin ekonomik të DokuFest 2011, këtë vit ndikimi në shpenzime është rritur për rreth 24%, kurse numri i vizitorëve për 50%.

Bazuar në Tabelën 1, numri i pjesëmarrësve pritët të rritet për 10% për çdo vit deri në vitin 2018, ndërsa ndikimi në bruto produktin vendorë (GDP) parashihet të arrijë nga 2.4 milionë në vitin 2015, në 3.2 milionë në vitin 2018. Ngjashëm rritje pritët të ketë edhe në konsum, në Tabelën 2 parashihet se rritja nga 4.7 milionë në vitin 2015, do të kalojë në 6.3 milionë në vitin 2018.

Si në vitin 2015 ashtu edhe në vitet 2016-2018 përfituesit kryesorë të festivalit pritët të janë bizneset lokale në qytetin e Prizrenit, si: kafe-baret, restorantet, shitësit ambulant, hotelet, qiradhënësit, etj., por edhe bizneset në nivel kombëtar, si avio-kompanitë, bankat apo kompanitë e telekomunikacionit. Po ashtu, rritje në të hyra janë regjistruar edhe në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Në krahasim me muajin korrik 2015, gjatë mbajtjes së DokuFest, të hyrat tatimore janë ngritur për 44%. Ndikimi ekonomik nuk kufizohet vetëm me qytetin e Prizrenit, ngase rritja e aktivitetit ekonomik përmes multiplikatorit qarkullon paranë në tërë Kosovën.

Prandaj, marrë parasysh rezultatet e analizën së parë të vitit 2011 dhe kësaj të vitin 2015, mund të përfundojmë se organizimi i DokuFest-it ka një ndikim të gjerë në ekonominë e vendit.



Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:

